



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 3 , Datë 13.09 2014

Për "Miratimin e studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga"

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 9, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 19.09.2014, mori në shqyrtim dokumentacionin e ardhur nga Bashkia e Tiranës me shkresën nr. 11838/1 prot. datë 05.09.2014 për "Miratimin e studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga", i hartuar nga firma projektuese "Gener 2" sh.p.k, protokolluar pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me shkresën nr.4656 prot datë 08.09.2014.

Projekt-zbatimi për "Studimin hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga", u paraqit nga firma projektuese "Gener 2" sh.p.k.

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi dëgjoi prezantimin nga projektuesit e firmës "Gener 2" sh.p.k. diskutimet dhe sugjerimet prej anëtarëve të saj, si dhe plotësimet e bëra nga ana e firmës projektuese",

VENDOSI :

Miratimin e "Studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga" për fazën e projekt-zbatimit.

PERI DISHNICA

KRYETAR